

VENDIM
Nr. 680, datë 26.10.2022

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT TË GODINËS SË KOPSHTIT PUBLIK VORË, BASHKIA VORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar; të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, dhe në vijim të vendimit nr. 7, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet dhe procedurat për shpronësimet dhe/ose shkëmbimin e pronës për interes publik në funksion të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar; e të vendimit nr. 8, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, në funksion të procesit të rindërtimit të godinës së kopshtit publik Vorë, Bashkia Vorë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Vorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, në vlerën 1 425 312 (një milion e katërqind e njëzet e pesë mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 425 312 (një milion e katërqind e njëzet e pesë mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekësh përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit dhe i transferohet Bashkisë Vorë, në buxhetin e vitit 2022, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Vorë.

8. Bashkia Vorë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Vorë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Rajonale Kamzë–Vorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, pasqyron në kartelat e pasurive të paluajtshme informacionin për miratimin e shpronësimit për interes publik të pasurive, pronë private, të cilat preken nga realizimi i projektit. Regjistrimi i aktit të kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Vorë do të kryhet pas aplikimit nga Bashkia Vorë për shërbimin përkatës.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Rajonale Kamzë–Vorë, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe regjistrimi i aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Vorë për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Rajonale Kamzë–Vorë dhe Bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

[illegible]